

**PËRFAQËSIMI I QYTETARËVE
NË KUVENDET E KOMUNAVE
TË REGJIONIT TË PRIZRENIT**

**REPRESENTATION OF CITIZENS
IN MUNICIPAL ASSEMBLIES
OF PRIZREN REGION**



STAFI

Ismet KRYEZIU - Drejtor Ekzekutiv
email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - Menaxhere e administratës dhe financave
email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ - Asistente për administratë dhe financa
email: lcikaj@kdi-kosova.org

Emine BEHLULI - Asistente për administratë dhe financa
email: ebehluli@kdi-kosova.org

PROGRAMI - QEVERISJA QENDRORE

Valmir ISMAILI - Menaxher programi
email: vismaili@kdi-kosova.org

Driton SELMANAJ - Asistent i programit
email: dselmanaj@kdi-kosova.org

Fitore ZENELI - Asistente e programit
email: fzeneli@kdi-kosova.org

Isuf ZEJNA - Monitorues
email: izejna@kdi-kosova.org

Ramadan KLISURICA - Monitorues
email: rklisurica@kdi-kosova.org

Rrezarta AHMETI - Monitorues
email: rrahmeti@kdi-kosova.org

PROGRAMI - QEVERISJA LOKALE

Naim CAHANAJ - Menaxher programi
email: ncahanaj@kdi-kosova.org

Nora VESELI - Koordinatorë
email: ncahanaj@kdi-kosova.org

PROGRAMI - TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI

Merita MUSTAFA - Menaxhere e programit
email: mmustafa@kdi-kosova.org

Admir ISTREFI - Asistent i programit
email: aistrefi@kdi-kosova.org

Besnik RAMADANAJ - Zyrtar për marrëdhënie me publikun
email: bramadanaj@kdi-kosova.org

Sahit BIBAJ - Avokat / Këshilltar juridik
email: sbibaj@kdi-kosova.org

Natyra KASUMAJ - Vullnetare
email: nkasumaj@kdi-kosova.org

Visar RAMAJ - Vullnetar
email: vramaj@kdi-kosova.org

BASHKËPUNËTOR TË JASHTËM

Arsim GJINOVCI - IT & design
email: agjinovci@kdi-kosova.org

www.kdi-kosova.org
email: info@kdi-kosova.org

Përmbajtja

• Hyrje	4
• Kuvendet e komunave.....	4
• Komuna e Prizrenit.....	4
• Komuna e Suharekës.....	7
• Komuna e Rahovecit.....	9
• Komuna e Malishevës.....	11
• Komuna e Dragashit.....	13
• Kryesimi i kuvendeve komunale.....	15
• Ekzekutivi i komunave.....	15
• Baza ligjore.....	15
• Rregullorja 2000/45.....	15
• Rregullorja 2007/30.....	16
• Ligji për Vetëqeverisje Lokale.....	16
• Drejtoritë Komunale.....	17
• Prizren.....	17
• Suharekë.....	17
• Rahovec.....	17
• Malishevë.....	17
• Dragash.....	17
• Sfidat e përfaqësimit qytetar.....	18
• Rekomandimet.....	19
• Përbërja aktuale e kuvendeve komunale.....	20
• Prizren.....	20
• Suharekë.....	21
• Rahovec.....	22
• Malishevë.....	23
• Dragash.....	24

HYRJE

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në kuadër të projektit “Pjesëmarrja e qytetarëve dhe principet për një qeverisje të mirë”, ka monitoruar punën e kuvendeve komunale të Regjionit të Prizrenit (Prizren, Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash) gjatë mandatit të kaluar të këtyre institucioneve, përkatësisht gjatë periudhës 2007 – 2009.

Pjesë e këtij projekti ka qenë edhe vlerësimi i punës së përfaqësuesve të zgjedhur nga qytetarët e këtyre komunave dhe subjekteve politike të përfaqësuara në kuvendet komunale¹, monitorimi i punës së organeve ekzekutive të këtyre komunave, fushatat e avokimit pranë këtyre institucioneve lidhur me çështjet që kanë qenë me interes për qytetarët e këtyre komunave dhe publikimi i raporteve periodike në lidhje me këto aktivitete.

Në këtë funksion është edhe ky publikim, i cili ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme për zhvillimet politike në komunat e Regjionit të Prizrenit dhe të shërbejë si një udhërrëfyes për qytetarët e këtij regjioni.

Për më tepër, në këtë publikim janë të përfshirë edhe përfaqësimi i qytetarëve në kuvendet komunale të Regjionit të Prizrenit në mandatin e kaluar (2007-2009) dhe në mandatin aktual të dalë nga Zgjedhjet 2009, ndryshimet në infrastrukturën ligjore në funksionimin e institucioneve të vetëqeverisjes lokale, ndryshimet në degën ekzekutive të këtyre komunave, sfidat e përfaqësimit të qytetarëve në institucionet lokale të këtyre komunave dhe rekomandimet e KDI-së në lidhje me këto çështje.

KOMUNA E PRIZRENIT

- Zgjedhjet 2007

Komuna e Prizrenit qeverisej nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), humbjet që i pësoj në zgjedhjet e viti 2007 kaluan në ndryshimet e para në qeverisje. Në zgjedhjet e 2007 Partia Demokratike e Kosovës (PDK) doli fituese dhe u mandatua për instalimin e qeverisjes pas balotazhit për kryetarë të komunave. Në këto zgjedhje PDK kishte fituar 12 ulëse karshi rivalit të saj LDK-së e cila kishte arritur të siguronte vetëm 10 ulëse në Kuvendin e Komunës së Prizrenit.

PDK kishte arritur marrëveshje me partitë opozitare (AKR, KDTP dhe VAKAT) për të përkrahur kandidatin e kësaj partie në balotazh mirëpo më një kundër kompensim që përfshinte edhe dhënien në menaxhim të disa drejtorive për këto subjekte politike. Megjithatë, legjislativin e kaluar e karakterizonin përplasjet e shumta ndërmjet pozitës-opozitës por edhe përplasje brenda anëtarëve të të njëjtit subjekt, me theks

¹KDI gjatë mandatit 2007-2009 ka publikuar tre Fletënotime në të cilat ka vlerësuar punën e përfaqësuesve të zgjedhur të qytetarëve dhe subjekteve politike të përfaqësuara në kuvendet komunale të Regjionit të Prizrenit.


Përfaqësimi i qytetarëve në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit

të veçantë brenda PDK-së. Si rezultat i kësaj disa nga anëtarët të subjekteve politike kishin kaluar në PDK dhe disa ishin deklaruar si të pavarur dhe funksionin e tyre pranë kuvendit e ushtronin si të tillë.

- Zgjedhjet 2009

Për marrjen e mandatit për qeverisje lokale në zgjedhjet e nëntorit 2009 kishin garuar gjithsej 21 subjekte politike dhe dy kandidatë të pavarur ndërsa për marrjen e kreut të ekzekutivit ishin gjithsej 13 kandidatë. Në raundin e parë të zgjedhjeve asnjë nga kandidatët për kryetarë të komunave nuk kishte marrë mjaftueshëm vota për të qeverisur qytetarët e komunës, mirëpo sfida vazhdon ndërmjet kandidatëve të PDK-së dhe LDK-së. Në raundin e dytë të zgjedhjeve vazhduan edhe me tej tensionet politike ndërmjet PDK-së dhe LDK-së duke akuzuar njëra tjetrën për keqmenaxhim dhe keqpërdorim të qeverisjes në mandatin e tyre. Me këtë edhe filluan koalicionet paraprake duke bërë koalicione me subjekte me të vogle politike për të mbështetur kandidatët e tyre në raundin e dytë të zgjedhjeve ku PDK në gjirin e vetë arriti t'i mbërthej disa subjekte politike si PD, KDTP, PSD, NDS dhe VAKAT por edhe LDK kishte arritur disa marrëveshje me subjektet politike si me AAK, LDD, AKR dhe SDA.

Gara sa thellohej edhe më tepër dhe në raundin e dytë të mbajtur me 15 dhjetorë 2009, secila parti pretendonte në fitore duke akuzuar njëra tjetrën për keqpërdorime dhe manipulim të votave (rezultati preliminar i KQZ-së ishte 50:50) dhe duke parashtruar ankesa të shumta pranë Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës. KZAP, pas gjithë atyre ankesave të bëra nga subjektet politike, kishte dhënë një udhëzim për KQZ-në me anë të të cilës i kishte rekomanduar asaj përsëritjen e votimeve në Komunën e Prizrenit. Vendimi i KQZ-së ishte marrë konform rekomandimeve të KZAP-it dhe si i tillë është vendosur edhe nga KQZ që të përsëriten votimet në Komunën e Prizrenit. Sidoqoftë, në zgjedhjet e përsëritura për Komunën e Prizrenit më 31 janar 2010 nga kutitë e votimit fitues doli kandidati i PDK-së Ramadan Muja.



Në këtë tabelë është paraqitur numri i anëtarëve të sigurara nga subjektet politike në Kuvendin Komunal nga zgjedhjet 2007 dhe 2009.

Përfaqësimi i qytetarëve në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit

Sipas rezultateve përfundimtare të KQZ-së, në legjislaturën e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Prizrenit do të përfaqësohen gjithsej 10 subjekte politike. PDK do të përfaqësohet me 12 anëtarë, LDK me 11, AAK me 4 anëtarë, KDTP me 3, LDD me 3, AKR, NDS dhe PD me nga dy anëtarë, ndërsa VAKAT dhe ORA në Kuvendin e Komunës së Prizrenit do të përfaqësohen me nga një anëtarë.

Në mandatin e ardhshëm katër vjeçar do të jenë gjithsej 28 anëtarë të cilët për herë të parë kanë marrë besimin e qytetarëve për përfaqësim të interesave të tyre pranë Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

- Performanca e anëtarëve gjatë periudhës 2007- 2009

Sipas vlerësimeve të KDI-së, anëtarët që kanë treguar performancë më të mirë në Fletënotimin Janar – Qershor 2008 janë: Haziz Hodaj (LDK), Ridvan Hoxha (LDK), Masar Shala (AAK), Haki Gajraku (LDD), Hasan Hasani (PDK), Vjosa Curri (ORA). Ndërsa anëtarët që nuk kanë treguar asnjë rezultat gjatë gjashtë mujorit të parë 2008 janë: Nehale Shëndeti (PDK), Sylbije Osmanaj (PDK), Shukri Quni (PDK), Qamil Buzhala (LDK), Agim Susuri (AKR) dhe Trëndelina Spahiu (AKR).

Anëtarët që kanë treguar performancë më të mirë në Fletënotimin për periudhën Korrik – Dhjetor 2008 janë: Hazizi Hodaj (LDK), Ridvan Hoxha (LDK), Haki Gajraku (LDD), Besnik Krasniqi (PDK), Afrim Avdaj (PDK). Ndërsa anëtarët që nuk kanë treguar asnjë rezultat gjatë gjashtë mujorit të dytë 2008 janë: Nehale Shëndeti (PDK) dhe Agim Susuri (AKR).

Anëtarët që kanë treguar performancë më të mirë në Fletënotimin për periudhën Janar – Gusht 2009 janë: Faik Miftari (i pavarur), Hazizi Hodaj (LDK) dhe Nijazi Kryeziu (PDK). Anëtarët që nuk kanë dhënë asnjë rezultat gjatë kësaj periudhe ishin: Sylbije Osmanaj (PDK), Shukri Quni (PDK), Agim Susuri (AKR) dhe Sebahate Ahmetaj (LDD).

Megjithatë, përkundër të dhënave të mësipërme, disa nga anëtarët që kanë treguar angazhim të lartë gjatë mandatit të kaluar nuk kanë arritur që në zgjedhjet e fundit lokale të marrin besimin e qytetarëve. Disa nga ata janë: Hasan Hasani, Faik Miftari, Masar Shala, Haki Gajraku, Agim Muqaj.

KOMUNA E SUHAREKËS


- Zgjedhjet 2007

Kuvendi Komunal i Suharekës është udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës për plotë nëntë vite. Kjo parti si më e madhja në këtë komunë në zgjedhjet e 2007 kishte arritur ti fitonte zgjedhjet si për Kuvendin e Komunës ashtu edhe për kryetarin e Komunës. Në këto zgjedhjet ky subjekt politik kishte arritur ti fiton 18 ulëse pranë Kuvendit Komunës, megjithatë edhe kjo parti për ta siguruar shumicën e votave në kuvendë kishte arritur marrëveshje koalicioni me partitë më të vogla opozitare si me LDD-në, AKR-në.

- Zgjedhjet 2009

Këtë komunë e karakterizuan ndryshme të mëdha në skenën politike në zgjedhjet e nëntorit 2009, ku për herë të parë LDK pëson rënie e cila deri në këto zgjedhje mbante primatin. Në garë për marrjen e mandatit pranë Kuvendit të Komunës kishin hyrë 9 subjekte politike ndërsa për kreun e ekzekutivit pesë kandidatë të cilët vinin nga radhët e LDK-së, PDK-së, AAK-së, LDD-së dhe PSK-së. Epilogu i rundit të parë të zgjedhjeve doli pa kryetarë mirëpo garën për balotazh e vazhduan kandidati i AAK-së ku për kundër kandidatë nuk e kishte më kandidatin e LDK-së por atë të PDK-së.

Humbja në balotazh i kandidatit nga subjekti politik i PDK-së , bënë që në mandatin katër vjeçar, ekzekutivi i kësaj komunë, për herë të par të qeveriset nga AAK-ja .Në mandatin e kaluar kjo parti kishte vetëm 2 ulëse pranë kuvendit mirëpo në zgjedhjet e fundit kishte një rritje të dukshme dhe u rëndit si forca e tretë politike e komunës duke marrë 10 ulëse në kuvendin e komunës.



Në këtë tabelë është paraqitur numri i anëtarëve të sigurara nga subjektet politike në Kuvendin Komunal nga zgjedhjet 2007 dhe 2009.

Në legjislaturën e ardhshme sipas rezultateve përfundimtare të KQZ-së do të përfaqësohen gjithsej gjashtë subjekte politike. Subjekti politik i LDK-së do të përfaqësohet me 11 ulëse, i PDK-së dhe AAK-së me nga 10 ulëse, i LDD-së me dy ulëse ndërsa subjekti politik i AKR-së dhe PSK-së me nga një ulëse.

Sipas Ligjit për Vetëqeverije Lokale numri i anëtarëve në Kuvendin e Komunës të një komune duhet të jetë proporcional, varësisht nga numri i qytetarëve në komunë. Përderisa Kuvendi i Komunës së Suharekës në legjislaturën e kaluara kishte 41 ulëse, në këtë mandate do të ketë vetëm 35 ulëse konform rregullimit ligjorë.

Në mandatin e ardhshëm katër vjeçar janë gjithsej 23 anëtarë të ri të cilët kanë marrë besimin e qytetarëve për përfaqësim të interesave pranë Kuvendit të Komunës së Suharekës, pa ndonjë përvojë të mëhershme në praktikat parlamentare.

- Performanca e anëtarëve gjatë periudhës 2007- 2009

Sipas vlerësimeve të KDI-së, anëtarët që kanë treguar performancë më të mirë në Fletënotimin Janar-Qershor 2008 janë: Muhamet Veliu, Hazir Hajdari dhe Rexhep Manxhuka (PDK), Shaqir Kryeziu dhe Sami Jupa (LDK). Anëtarët që nuk kanë treguar asnjë rezultat gjatë gjashtë muorit të pra të 2008 janë: Feti Kuqi, Lira Mala, Hidajeta Haliti, Malësore Elshani, Shukrie Salihu (LDK), Arfi Daka, Elmaze Kabashi, Hanife Rakiqi, Sevdije Sadiku, Zoja Zenelaj (PDK), Lonora Reshitaj (LDD) dhe Isuf Krasniqi (PD).

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës që kanë shënuar rezultat më të kënaqshëm në Fletënotimin Korrik-Dhjetor 2008 janë: Safet Hoxha (PDK) dhe Adem Kadolli (LPK). Anëtarët të cilët nuk kanë treguar asnjë rezultat gjatë gjashtë muorit të dytë 2008 ishin: Shukrie Salihu, Tahir Kolgeci (LDK), Driton Krasniqi, Elmaze Kabashi, Sevdije Sadiku, Zoja Zenelaj (PDK) dhe Hanife Rakaqi (LPK).

Anëtarët që kanë treguar rezultat më të kënaqshëm në Fletënotimin Janar-Gusht 2009 janë: Safet Hoxha, Hazir Hajdari (PDK) dhe Adem Kadolli (LPK). Anëtarët që nuk kanë shënuar asnjë rezultat gjatë kësaj periudhe ishin: Lira Mula, Remzi Bytyqi (LDK), Fatmir Guraziu (PDK), Bahrije Kokollari (LDD) dhe Hanife Rakaqi (LPK).

Edhe përkundër rezultatit të shkëlqyer të këtyre anëtarëve disa nga ta në zgjedhjet e fundit lokale nuk kanë arritur të marrin besimin e qytetarëve dhe ata janë: Hazir Hajdari, Muhamet Veliu, Rexhep Manxhuka, Shaqir Kryeziu, Xhemajli Shala.

Përfaqësimi i qytetarëve në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit


KOMUNA E RAHOVECIT

- Zgjedhjet 2007

Komuna e Rahovecit në mandatin e kaluar është udhëhequr nga PDK, parti kjo e cila për herë të parë vjen në pushtat në këtë Komunë pas zgjedhjeve të mbajtura në 2007. Në këto zgjedhje ky subjekt politik kishte arritur të merrte kreun e ekzekutivit dhe 11 ulëse në kuvendin e komunës ndërsa bashkëqeverisja me disa subjekte të vogla (LKÇK dhe AKR) i mundësonte të kishte numrin e mjaftueshëm të votave për marrjen e vendimeve në kuvendin e komunës.

- Zgjedhjet 2009

Në zgjedhjet e nëntorit 2009 për kuvendin e komunës së Rahovecit kishin hyrë në garë shtatë subjekte politike, mirëpo edhe kësaj radhe PDK-ja në këtë komunë del si subjekti më i madh politik duke marrë 10 ulëse në kuvendë mirëpo krahasuar me zgjedhjet 2007 ky subjekt politik nuk ka arritur të ruaj numrin e ulëseve pranë kuvendit. Vlen të theksohet rritja e subjektit të AKR ku në mandatin e kaluar është përfaqësuar vetëm me dy përfaqësues ndërsa në zgjedhjet nëntorit 2009 ka arritur të rrisë numrin e përfaqësimit pranë kuvendit për dy ulëse kurse subjektet tjera mbesin të njëjta me përjashtim të LDD-së e cila ka humbur një përfaqësim. Edhe për kreun e ekzekutivit pranë kuvendit komunal kishin kandiduar katër subjekte politike (LDK, PDK, AKR dhe AAK), mirëpo vetëm pas balotazhit ndërmjet PDK-së dhe LDK-së është arritur të dihet udhëheqja e kësaj komunë, ku Partia Demokratike e Kosovës arrin të marrë besimin e qytetarëve edhe për një mandat katër vjeçar kundruall rivalit të saj Lidhjes Demokratike të Kosovës.



Në këtë tabelë është paraqitur numri i anëtarëve të sigurara nga subjektet politike në Kuvendin Komunal nga zgjedhjet 2007 dhe 2009.

Në legjislaturën e ardhshme sipas rezultateve përfundimtare të KQZ-së do të përfaqësohen gjithsej shtatë subjekte politike. Subjekti politik i PDK-së do të përfaqësohet me 10 ulëse, i LDK-së me 8 ulëse, i AAK-së me 5 ulëse, AKR-së me 4 ulëse, LIB- i do të përfaqësohet me 2 ulëse ndërsa subjekti politik i PD-së dhe LDD-së do të përfaqësohen vetëm me nga një ulëse.

Në mandatin e ardhshëm katër vjeçar janë gjithsej 22 anëtarë të ri të cilët kanë marrë besimin e qytetarëve për përfaqësim të interesave të tyre pranë Kuvendit të Komunës së Rahovecit, pa ndonjë përvojë të mëhershme në praktikën parlamentare.

- Performanca e anëtarëve gjatë periudhës 2007- 2009

Sipas vlerësimeve të KDI-së, anëtarët që kanë treguar performancë më të mirë në Fletënotimin Janar-Qershor 2008 janë: Agim Thaqi Enver Sylka (AAK), , Xhemajli Haxhimustafa (PDK), Nahit Elshani dhe Bedredin Shehu (LDK), Sali Hoti dhe Florija Boshnjaku LKCK).

Anëtarët që nuk kanë treguar asnjë rezultat në gjashtë mujorin e parë 2008 ishin: Beatrisa Demiri dhe Jahja Shehu (PDK), Nazife Hundozi dhe Shahzije Vuqitërna (LDK), Bajram Morina (AKR), Sahadete Dula (LDD) dhe Hamdi Dërmale (PD).

Anëtarët që kanë treguar rezultate të kënaqshme në Fletënotimin Korrik-Dhjetor 2008 ishin: Nahit Elshani, Avdullah Kryeziu (LDK) dhe Enver Sylka (AAK). Anëtarët që nuk kanë treguar asnjë rezultat në të gjitha kategorit ishin: Beatrisa Demiri, Diellza Hoxha (PDK), Nazife Hundozi (LDK), Bajram Morina (AKR) dhe Hamdi Dërmale (PD).

Anëtarët që kanë treguar rezultate më të mira në Fletënotimin Janar-Gusht 2009 janë: Feim Fetoshi (AAK), Bedredin Shehu (LDK), Xhemajli Haxhimustafa (PDK) dhe Sali Hoti (LKCK). Anëtarët që nuk kanë treguar asnjë rezultat gjatë kësaj periudhe ishin: Nazife Hundozi (LDK), Baram Morina (AKR), Baton Cena, Jaja Shehu, Fatmir Kadiri (PDK) dhe Hamdi Dërmala (PD).

Edhe përkundër faktit që kanë dhënë një kontribut të çmueshëm në legjislaturën e kaluar, në zgjedhjet lokale të nëntorit disa nga këta anëtarë nuk kanë arritur të marrin besimin e qytetarëve dhe ata janë: Bedredin Shehu, Enver Sylka dhe Agim Thaqi.

KOMUNA E MALISHEVËS

- Zgjedhjet 2007


Qeverisja e kaluar e kuvendit komunal të Malishevës ishte e udhëhequr nga PDK-ja e cila qeverisë me qytetarët e kësaj komune në dy mandate.. Ky subjekt politik në mandatin e kaluar kishte gjithsej 16 anëtarë në kuvendin e komunës mirëpo pranë vetës kishte edhe disa subjekte të vogla politike të cilat e përkrahin në marrjen e vendimeve edhe pse zyrtarisht nuk kishin bërë koalicion.

- Zgjedhjet 2009

Në zgjedhjet e nëntorit 2009 në këtë komunë kishin garuar shtatë subjekte politike dhe pesë kandidatë për kryetarë të Komunës nga radhët e PDK-së,LDK-së,AAK-së,AKR-së dhe një kandidat i pavarur. Edhe në këtë komunë asnjë nga kandidatët për kryetarë të komunës nuk kishte arritur të merrte mbi 50 % te votave dhe mbeti të shkojnë në balotazh dy kandidatët, njëri nga PDK dhe tjetri nga LDK, subjekte këto si më të madha në komunën e Malishevës.

Pas mbajtjes së balotazhit si fituese e kreut të ekzekutivit doli kandidati i subjektit politik të PDK-së me një përqindje dukshëm më të lartë se ai i LDK-së.

Kuvendi i Komunës së Malishevës ka mbajtur mbledhjen konstituive dhe kanë dhënë betimin kryetari dhe anëtarët e kuvendit nga radhët e PDK-së,AAK-së dhe AKR-së mirëpo jo edhe anëtarët e LDK-së dhe LDD-së ku shihet qartë qëndrimi destruktiv i kësaj partie.



. Në këtë tabelë është paraqitur numri i anëtarëve të sigurara nga subjektet politike në Kuvendin Komunal nga zgjedhjet 2007 dhe 2009.

Edhe në mbledhjen e parë të Kuvendit të Komunës së Malishevës, përkundër ftesës për dhënien e betimit të anëtarëve të cilët nuk e kanë bërë një gjë të tillë në seancën konstituive, këta të fundit nuk e përfillën duke u arsyetuar në mos respektimin e procedurave ligjore përkatësisht shkeljen e statutit të komunës i cili thotë se seancën e parë duhet të udhëhiqet nga anëtari me i vjetër i kuvendit e jo nga kryetari i komunës. Vlen të ceket se përfaqësuesi i AKR-së publikisht ka pranuar të jetë përkrahe PDK-së.

Në legjislaturën e ardhshme sipas rezultateve përfundimtare të KQZ-së do të përfaqësohen gjithsej pesë subjekte politike. Subjekti politik i PDK-së do të përfaqësohet me gjithsej 16 ulëse, i LDK-së me 11 ulëse, i AAK-së me 2 ulëse ndërsa subjektet politike AKR dhe LDD me nga një ulëse.

Në mandatin e ardhshëm katër vjeçar janë gjithsej 21 anëtarë të ri të cilët kanë marrë besimin e qytetarëve për përfaqësim të interesave të tyre pranë Kuvendit të Komunës së Malishevës, pa ndonjë përvojë të mëhershme në praktikën parlamentare.

- Performanca e anëtarëve gjatë periudhës 2007- 2009

Sipas vlerësimeve të KDI-së, anëtarët që kanë treguar performancë më të mirë në Fletënotimin Janar-Qershor 2008 janë: Januz Kastrati, Hamdi Mazreku, Sadri Robaj (LDK), Mursel Gashi dhe Qamil Hoti (PDK). Anëtarët që nuk kanë treguar asnjë rezultat në gjashtë mujorin e parë 2008 janë: Hasime Krasniqi, Naim Kryeziu, Merita Krasniqi, Afrim Zogaj, Rajmonda Kryeziu, Lumni Kryeziu Zemire Lima (PDK), Zahide Kastrati, Bukurije Mazreku, remie Thqai (LDK).

Anëtarët që kanë dhënë rezultate më të kënaqëshme në Fletënotimin Korrik-Dhjetor 2008 ishin: Januz Kastrati dhe Hamdi Mazreku (LDK). Anëtarët të cilët nuk kanë treguar asnjë rezultat gjatë gjashtë mujorit të dytë 2008 ishin: Naim H Morina, Lumni Kryeziu (PDK) dhe Sadbere Hoxha (LDK).

Anëtarët që kanë treguar rezultate më të mira në Fletënotimin Janar-Gusht janë: Januz Kastrati, Hamdi Mazreku (LDK) dhe Qamil Hoti (PDK). Anëtarët që nuk kanë treguar asnjë rezultat gjatë kësaj periudhe kohore ishin: Afrim Zoga, Lumni Kryeziu, Besim Dobruna (PDK) dhe Bukurije Mazreku (LDK).

Edhe përkundër faktit se kanë dhënë një kontribut të çmueshëm në legjislaturën e kaluar në zgjedhjet lokale të nëntorit disa nga këta anëtarë nuk kanë arritur të marrin besimin e qytetarëve dhe ata janë: Hamdi Mazreku, Sadri Robaj, Adem Krasniqi, Sinan Gegaj, Mursel Gashi dhe Qamil Hoti.

KOMUNA E DRAGASHIT

- Zgjedhjet 2007


Në komunën e Dragashit ndërrimet e para të strukturës qeverisë vinë pas zgjedhjeve të mbajtura në vitin 2007. Lidhja Demokratike e Kosovës e cila qeverisi këtë komunë për plotë shtat vite pëson humbjen e parë nga Partia Demokratike e Kosovës.

Ky subjekt politik i cili kishte arritur të marrë udhëheqjen e ekzekutivit dhe bashkë me këtë edhe 11 ulëse në Kuvendin e Komunës mandatohet për instalimin e qeverisjes komunale. Gjatë këtij mandati Partia Demokratike e Kosovës bashkë qeverisë me subjektin politik VAKAT, subjekt ky i cili përfaqëson komunitetin pakicë në këtë komunë.

- Zgjedhjet 2009

Në zgjedhjet e nëntorit 2009 për kuvendin e komunës së Dragashit kishin hyrë në garë tetë subjekte politike, mirëpo edhe kësaj radhe PDK-ja në këtë komunë del si subjekti më i madh politik duke marrë nëntë ulëse në kuvend. Edhe për kreun e ekzekutivit pranë kuvendit komunal kishin kandiduar pesë subjekte politike (LDK, PDK, AKR, AAK dhe VAKAT), mirëpo vetëm pas balotazhit ndërmjet PDK-së dhe LDK-së është arritur të dihet udhëheqja e kësaj komunë. Në këto zgjedhje PDK arrin të marrë besimin e qytetarëve edhe për një mandat katër vjeçar kundrejt rivalit të tij që pësoi humbje edhe në zgjedhjet 2007 - Lidhja Demokratike e Kosovës.

Në legjislaturën e ardhshme sipas rezultateve përfundimtare të KQZ-së do të përfaqësohen gjithsej tetë subjekte politike. Subjekti politik i PDK-së dhe LDK-së do



Në këtë tabelë është paraqitur numri i anëtarëve të sigurara nga subjektet politike në Kuvendin Komunal nga zgjedhjet 2007 dhe 2009.

përfaqësohen me nga 9 ulëse , VAKAT me tri ulëse ,i AAK-së me dy ulëse ndër-
sa subjektet politike LDD,AKR,GIG dhe SDA me nga një ulëse.

Në mandatin e ardhshëm katër vjeçar janë gjithsej 18 anëtarë të ri të cilët kanë marrë besimin e qytetarëve në zgjedhjet e 15 nëntorit për përfaqësim të intereseve të qytetarëve pranë Kuvendit të Komunës së Dragashit, pa ndonjë përvojë të mëhershme në praktikat parlamentare.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale numri i anëtarëve në Kuvendin e Komunës të një komune duhet të jetë proporcional, varësisht nga numri i qytetarëve në komunë. Përderisa Kuvendi i Komunës së Dragashit në legjislaturën e kaluar kishte 21 ulëse, në këtë mandate do të ketë vetëm 27 ulëse kjo konform rregullimit ligjorë.

- Performanca e anëtarëve gjatë periudhës 2007- 2009

Sipas vlerësimeve të KDI-së, anëtarët që kanë treguar performancë më të mirë në Fletënotimin Janar-Qershor 2008 janë: Qamil Kolloni (LDD), Ymer Ademi dhe Naim Ramadani (LDK), Sabidin Çufta VAKAT), Mahmut Mahmuti (AAK), Lulzim Rifaj dhe Ibrahim Gashi (PDK)

Anëtarët që nuk kanë dhënë asnjë rezultat gjatë kësaj periudhe ishin: Adelina Qafleshi dhe Arbnore Kurtishi (PDK).

Anëtarët që kanë dhënë kontribut të çmueshëm në Fletënotimin Korrik-Dhjetor 2008 ishin: Naim Ramadani, Ymer Ademi (LDK),Qamil Kolloni (LDD) dhe Mahmut Mahmut (AAK).

Anëtarët që kanë treguar rezultate më të mira në Fletënotimin Janar-Gusht 2009 janë: Naim Ramadani, Ymer Ademi, Xhemail Iljazi (LDK) dhe Qamil Kolloni (LDD). Anëtari që nuk ka treguar asnjë rezultat gjatë kësaj periudhe ishin: Arbnore Kurtishi (PDK).

Edhe përkundër faktit që kanë dhënë një kontribut të çmueshëm në legjislaturën e kaluar disa nga këta anëtarë në zgjedhjet e nëntorit nuk kanë arritur të marrin besimin e qytetarëve dhe ata janë: Xhemail Iljazi dhe Sabidin Çufta.

Përfaqësimi i qytetarëve në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit

KRYESIMI I KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Sistemi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë deri në vitin 2008 nuk ka paraparë postin “Kryesues i Kuvendit të Komunës”. Në përputhje me Rregulloret e UNMIK-ut 2000/45 dhe 2007/30 Kryetari i Komunës ka pasë të rezervuar të drejtën e thirrjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe kryesimin e atyre mbledhjeve.

Me ndryshimin e statusit të Kosovës përkatësisht shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe miratimin më 20 shkurt 2008 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale parashihet që punimet e kuvendeve komunale të udhëhiqen nga ana e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës i cili zgjedhet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës me mandat të njëjtë sikur anëtarët tjerë të këtij institucioni (Neni 41 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale).

Në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit kanë zgjedhur kryesuesit e tyre të cilët kanë ushtruar detyrën e tyre gjatë mandatit dyvjeçar 2007 – 2009².

Megjithatë, përkundër angazhimit të tyre në udhëheqjen e këtij institucioni, Rexhep Kuçi (Suharekë), Xhemajli Haxhimustafa (Rahovec) dhe Mursel Gashi (Malishevë) nuk kanë arritur të fitojnë vota të mjaftueshme për të qenë edhe në një mandat anëtarë të institucioneve të cilat i kanë kryesuar në mandatin e kaluar. Ndërkohë që Nijazi Kryeziu (Prizren)³ dhe Lulzim Rifaj (Dragash) kanë fituar të drejtën për të qenë anëtarë të kuvendeve komunale përkatëse edhe për një mandat të ardhshëm katër vjeçar.

Ekzekutivi i komunave

Baza Ligjore
- Rregullorja 2000/45

Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 specifikonte ndryshe rregullimin zgjedhjes dhe udhëheqjes së brendshme të kuvendeve të komunave. Sipas kësaj rregullore Kryetari i Komunës nuk zgjidhet drejtpërdrejt nga ana e qytetarëve por zgjedhjen e kryetarit e bënte Kuvendi i Komunës nga ana e anëtarëve të tij.

² Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit - Nijazi Kryeziu (PDK);
Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës – Rexhep Kuçi (LDK);
Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit – Xhemajli Haxhimustafa (PDK);
Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës – Mursel Gashi (PDK);
Kryesues i Kuvendit të Komunës së Dragashit – Lulzim Rifaj (PDK).

³ Neni 7.5, Ligji për Zgjedhjet Lokale parasheh: “Vota e hedhur për subjektin politik konsiderohet si votë për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të subjektit politik.”

PPërfaqësimi i qytetarëve në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit

Kuvendi i komunës, në bazë të propozimit të kryetarit, emëronte Kryeshefin Ekzekutiv, i cili kryente detyrën e Sekretarit të Kuvendit të Komunës, kryesonte Bordin e Drejtorëve, udhëheqte çështjet financiare të komunës dhe detyrat tjera që përcaktoheshin nga ana e Kryetarit të Komunës.

Kuvendi komunal përveç zgjedhjes së Kryetarit dhe Kryeshefit Ekzekutiv emëronte edhe Bordin e Drejtorëve, ku përfshiheshin drejtorët e drejtorive komunale si dhe Drejtori i Zyrës së Komuniteteve. Bordi i Drejtorëve kishte kompetencë në këto fusha: ndihmonte Kuvendin e Komunës dhe komitetet e tij në sigurimin e të gjitha informatave dhe raporteve për procesin e marrjes së vendimeve, ndihmon Kryetarin e Komunës dhe Kryeshefin Ekzekutiv dhe zbatonte të gjitha vendimet e Komunës.

- Rregullorja 2007/30

Me ndryshimin e Rregullores 2000/45 dhe hyrjen në fuqi të Rregullores 2007/30 për vetëqeverisje lokale ka ndryshuar edhe përbërja e organeve të Kuvendit të Komunës dhe mënyra e zgjedhjes së këtyre organeve. Sipas kësaj Rregulloreje, Kryetari i Komunës zgjedhet drejtpërdrejt nga njerëzit që kanë të drejtë vote në komunë në përputhje me Ligjin mbi Zgjedhjet Komunale që është në fuqi.⁴

Drejtoritë komunale themeloheshin në bazë të statutit komunal kurse Kryetari i Komunës emëronte drejtorët për secilin drejtori. Drejtorët e drejtorive komunale ishin kompetent për drejtimin dhe udhëheqjen e drejtorive përkatëse dhe i përgjigjeshin Kryetarit të Komunës. Përjashtim nga kjo bënte vetëm Drejtoria e Administratës dhe Personelit i cili funksiononte nën drejtimin dhe udhëheqjen e shefit të drejtorisë dhe i cili ishte nën autorizimet e përgjithshme të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit.⁵

- Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale zgjedhja e Kryetarit të Komunës behet me vota të drejtpërdrejta nga ana e qytetarëve të komunës për një periudhë katër vjeçare.⁶

Kryetari i Komunës ka kompetencë në udhëheqjen e ekzekutivit të komunës dhe administratën e saj, mbikëqyrë administrimin financiar të komunës, emëron dhe shkarkon anëtarët të cilët i ndihmojnë në kryerjen e detyrave.

Administrata komunale organizohet në drejtori ku çdo drejtori komunale menaxhohet nga drejtori përkatës. Drejtorët komunal emërohen dhe shkarkohen nga ana e Kryetarit të Komunës.⁷

⁴Neni 24.1, Rregullorja e Unmiku-ut 2007/30.

⁵Neni 29.2, Rregullorja e Unmiku-ut 2007/30.

⁶Neni 56, Ligji për Vetëqeverisje Lokale.

⁷Neni 66, Ligji për Vetëqeverisje Lokale.

Përfaqësimi i qytetarëve në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit

DREJTORITË NË KOMUNA

- Komuna e Prizrenit

Në Komunën e Prizrenit gjatë qeverisjes dy vjeçare, ekzekutivi i kësaj Komune funksionoi me 11 drejtori komunale: gjashtë drejtori janë udhëhequr nga subjekti politik i PDK-së, tri drejtori nga AKR dhe me nga një drejtori kanë udhëhequr KDTP dhe subjekti politik i ORA-s. Deri në momentet e hartimit të këtij publikimi ende nuk është bërë themelimi i drejtorive komunale dhe emërimi i drejtorëve në Komunën e Prizrenit.

- Komuna e Suharekës

Në komunën e Suharekës gjatë qeverisjes dy vjeçare ekzekutivi funksionoi me nëntë drejtori: shtatë drejtori janë udhëhequr nga subjekti politik i LDK-së dhe dy drejtori janë udhëhequr nga subjekti politik i LDD-së. Edhe pas konstituimit të qeverisë së re lokale nga ana e kryetarit janë propozuar nëntë drejtori ku drejtorja e Inspektoratit ka hyrë si sektorë i veçantë në drejtorinë e Administratës ndërsa është themeluar një drejtori e re ajo e Mërgatës. Nga nëntë drejtori shtatë prej tyre do të udhëhiqen nga AAK ndërsa, edhe pse jo zyrtarisht pjesë e koalicionit, me nga një drejtori do të udhëhiqin LDK dhe LDD.

- Komuna e Rahovecit

Edhe Kuvendi i Komunës së Rahovecit gjatë mandatit dy vjeçar të qeverisjes ka funksionuar me tetë drejtori, pesë prej të cilave janë udhëhequr nga subjekti politik i PDK-së dhe me nga një drejtori kanë udhëhequr subjektet politike të cilat ishin në koalicion qeverisës me këtë subjekt (AKR, PD dhe LKCK). Me konstituimin e qeverisë së re lokale, nga ana e kryetarit të kësaj komune gjatë mandatit propozuar tetë drejtori mirëpo udhëheqja e tyre akoma nuk dihet për arsye të mos zyrtarizimit të koalicioneve të mundshme me subjektet politike opozitare.

- Komuna e Malishevës

Në komunën e Malishevës gjatë qeverisjes dy vjeçare ekzekutivi funksionoi me tetë drejtori dhe që të gjitha janë udhëhequr nga subjekti politik i PDK-së. Me konstituimin e qeverisë së re lokale, nga ana e Kryetarit të Komunës janë propozuar njëmbëdhjetë drejtori (disa nga sektorët në kuadër të drejtorive kanë kaluar në drejtori). Dhjetë nga këto drejtori do të udhëhiqen nga subjekti politik i PDK-së dhe një drejtori do të udhëhiqet nga AKR.

- Komuna e Dragashit

Kuvendi komunal i Dragashit në mandatin dy vjeçar të qeverisjes ka funksionuar me shtatë drejtori, katër prej të cilave janë udhëhequr nga subjekti politik i PDK-së dhe tri drejtori janë udhëhequr nga subjekti politik VAKAT e cila ishte edhe pjesë e koalicionit qeverisës. Në këtë mandat nga ana e kreut të ekzekutivit planifikohet rritja e numrit të drejtorive, mirëpo, meqenëse në Statutin e Komunës së Dragashit është e specifikuar numri i drejtorive që mund të themelohen në këtë komunë, rritja e numrit të drejtorive komunale duhet të përcillet me ndryshimin e Statutit të Komunës së Dragashit procedurë e cila duhet të miratohet nga 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Dragashit.

SFIDAT E PËRFAQËSIMIT QYTETAR

Instituti Demokratik i Kosovës, krahas publikimit të fletnotimit, gjatë periudhës 2007 - 2009 ka publikuar edhe disa analiza në fusha të veçanta ku ka specifikuar mangësitë dhe ka dalë me disa rekomandime me qëllim të rritjes së efikasitetit të kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit. Megjithatë jo çdo herë këto institucione kanë qenë të gatshme për implementimin e këtyre rekomandimeve, andaj për këtë mandat të arshëm katër vjeçar institucioneve lokale të këtij regjioni u mbetet sfidë zbatimi këtyre rekomandimeve me qëllim të avancimit të punës së tyre në drejtim të përfaqësimit sa më dinjitoz të interesave të qytetarëve.

Çështja kryesore me të cilën merret ky shqyrtim është pritshmëria e subjekteve politike për kandidatët e votuar tashmë të përfaqësuar në kuvendet komunale, sfidat me të cilat do të përballet funksionimi i legjislativit komunal, efektet, pasojat dhe ndikimet që mund të ketë në përfaqësimin sa më të denjë të qytetarëve. Sipas anëtarëve të kryesive, pritshmëria e subjekteve politike për t'u zgjedhur kandidatët që mund të japin maksimumin në kuvend nuk është përmbushur në tërësi. Me këtë edhe janë rritur sfidat në përmirësimin e performancës së organit legjislativ gjegjësisht kuvendeve komunale.

Këto sfida të identifikuar janë shkak i një mori çështjesh për të cilat sfidohen dhe vet subjektet politike në ditët e sotme. Një ndër shkaqet është programi politik, gjegjësisht jo-konkretizimi i programeve lokale politike. Elektoratit kryesisht i është ofruar programi i përgjithshëm politik, por jo i dhënë në detaje për zgjidhjen e brengave dhe shqetësimeve të përditshme të tyre që kanë të bëjnë me ingerencat komunale. Ndër shkaqet tjera është dhe vet sistemi zgjedhor në kuptimin e ndarjes administrative. Edhe pse nuk është e përcaktuar me ligj, subjektet politike nuk e kanë shfrytëzuar mundësinë e përzgjedhjes së kandidatëve të përfaqësuar nga të gjitha zonat e komunës ashtu që të kenë mundësi për përfaqësim të të gjithë qytetarëve dhe me këtë të rrit edhe elektoratin ose numrin e votuesve. Në anën tjetër, shkak tjetër është mungesa e informacionit që ka bërë votuesit të mos jenë të informuar për të gjithë kandidatët e subjektit politik garues. Fushatat parazgjedhore nuk janë përqendruar në promovimin e të gjithë kandidatëve brenda një subjekti politik, duke lënë kështu anash një pjesë të kandidatëve për të cilët votuesit nuk kanë marrë informacione për kapacitetet, shkathtësitë dhe kompetencat e tyre në mënyrë që t'u japin votën. Po ashtu profilizimi ende i papërcaktuar i subjekteve politike ka shkaktuar hamendësimet tek votuesit për të zgjedhur kandidatët kompetentë për përfaqësim. Ndër shkaqet tjera por që mund të thuhet se përfaqësohet në masë të madhe është dhe militantizmi partiak, të cilit i kanë paraprirë marrëveshjet joformale ose interne të degës së subjektit politik për votimin e kandidatit të caktuar për një lokacion të caktuar, pastaj gara jo adekuate mes kandidatëve të një subjekti politik gjegjësisht ndërhyrja në territor të kandidatit të po të njëjtës parti dhe në fund prezenca e dukurisë së votimit familjar.

Nga çështja kryesore e sfidës kyçe në këtë dokument shqyrtimi, si rrjedhojë, kuvendet e komunave do të përballen me çështje të cilat kërkojnë trajtim imediat. Në përgjithësi kuvendet e komunave do të përballen me kapacitetet e pamjaftueshme për për-

Përfaqësimi i qytetarëve në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit

faqësim, që do të thotë se shumica e kandidatëve tashmë të zgjedhur nuk kanë njohuri për qeverisjen lokale, nuk janë të familjarizuar me legjislacionin në fuqi, me organet komunale e sidomos me ekzekutivin të cilin duhet mbikëqyrë. Po ashtu, kuvendarët e rinj mund të mos e dinë peshën e komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, që do të thotë se nuk do të jenë në mundësi t'i shfrytëzojnë të gjithë mekanizmat për komunikim të drejtpërdrejtë me qytetarët, çështje kjo e identifikuar edhe në qeverisjet komunale të mëparshme. Kjo do të bëjë që perceptimi, i cili ka dhe bazë reale, i qytetarëve se nuk janë të përfaqësuar të mbetet sfidë edhe për qeverisjet komunale aktuale. Mos-shfrytëzimi i mekanizmave të komunikimit shkakton mos-marrjen e informacionit kthyes nga vet qytetarët, me çka ullet intensiteti i komunikimit dy-kahor mes të zgjedhurve dhe zgjedhësve. Po ashtu, si pasojë e sfidës kyçe kuvendarët e rinj do të marrin vendimet komunale pa shqyrtim kritik, mbi parimin e shumicës dhe në raste të tjera vendimet komunale do t'i sjellin sipas diktatit të subjektit politik. E gjitha kjo do të zvogëlojë rolin aktiv për mbikëqyrje të ekzekutivit.

Rekomandimet:

- Të konkretizohen programet politike komunale me qëllim që qytetarët të jenë më të informuar për këto programe politike, në detaje të specifikohen se si do të zgjidhen brengat dhe shqetësimet e përditshme të tyre;
- Nga ana e Komunës dhe subjekteve politike të lobohet në MAPL dhe Qeveri për ndryshimin e nenit 7 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale ku specifikon Komunën si zonë të vetme zgjedhore, me qëllim të ndarjes administrative që do të krijohen mundësit për një përfaqësim të zonave në mënyrë sa më proporcional;
- Të përkrahen të gjithë kandidatët nga subjektet politike ashtu që në njërin anë a) të rrisin numrin e votuesve për të dalë në zgjedhje dhe në anën tjetër b) të rrisin numrin e elektoratit të vetë;
- Të shfrytëzohen të gjithë mekanizmat e komunikimit me qytetarë që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Statuti me qëllim që të kemi një pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në vendimmarrje;
- Të funksionalizohet zyra pritëse për qytetarë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, jo vetëm në marrjen e brengave të tyre por edhe në kthimin e përgjigjeve brenda një afati sa më të shkurtër lidhur me atë çështje që i prokupon qytetarët;
- Të hartohet një pako trajnuese për anëtarët e Kuvendeve të Komunave dhe të identifikohen modulet trajnuese që do të rrisin vetëdijen e anëtarëve për rolin dhe përgjegjësit që kanë marrë.

Anëtarët e rinj të Kuvendit të Komunës së Prizrenit

Nr	Anëtarët	Subjekti politik	Numri i votave të marra në zgjedhjet e fundit
1	Nijazi Kryeziu	PDK	15,963
2	Afrim Avdaj	PDK	1,171
3	Besnik Krasniqi	PDK	859
4	Xhemshit Krasniqi	PDK	749
5	Shukri Quni	PDK	722
6	Naser Berisha	PDK	684
7	Gzim Duraj	PDK	665
8	Hajrim Qengaj	PDK	645
9	Sylbije Osmanaj	PDK	288
10	Laura Guguli	PDK	282
11	Bajrame Tafallari	PDK	172
12	Adelina Beqiri	PDK	150
13	Ridvan Hoxha	LDK	14.205
14	Haziz Hodaj	LDK	1.012
15	Xhavit Uka	LDK	955
16	Shukri Vezaj	LDK	664
17	Fatmir Memaj	LDK	417
18	Qemal Krasniqi	LDK	408
19	Cen Fanaj	LDK	406
20	Lulije Buzhala	LDK	309
21	Arjeta Nezaj	LDK	274
22	Kimete Hoxha	LDK	239
23	Gjyzel Shalijani	LDK	174
24	Fatmir Kastrati	AAK	4.531
25	Sulltan Badalli	AAK	476
26	Vjosa Smajlaj	AAK	167
27	Afërdita Saramati	AAK	115
28	Lulzim Kabashi	LDD	3.506
29	Sefer Rexhaj	LDD	700
30	Ardita Ibrahim	LDD	58
31	Fatmir Lipoveci	AKR	2.369
32	Elizabeta Tara	AKR	53
33	Munir Basha	PD	2.11
34	Nora Murataj	PD	34
35	Petrit Randobrave	ORA	826
36	Orhan Lopar	KDTP	4.021
37	Ergin Kala	KDTP	456
38	Fidan Jilta	KDTP	149
39	Emilijja Redzeqi	NDS	2251
40	Oruc Karadolami	NDS	235
41	Cemajl Kurtisi	Vakat	1819

Përfaqësimi i qytetarëve në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit

Anëtarët e rinj të Kuvendit të Komunës së Suharekës			
Nr	Anëtarët	Subjekti politik	Numri i votave të marra në zgjedhjet e fundit
1	Sali Asllanaj	LDK	7965
2	Sehad Haliti	LDK	562
3	Shefket Kolgeci	LDK	425
4	Qazim Voci	LDK	345
5	Sami Jupaj	LDK	337
6	Kimete Bytyqi	LDK	288
7	Nexhat Ramadani	LDK	299
8	Avdyl Sopaj	LDK	282
9	Elmaze Bytyqi	LDK	272
10	Lavdija Bukoshi	LDK	212
11	Luljeta Baraliu	LDK	196
12	Vesel Maliqaj	AAK	6824
13	Shefket Kuqi	AAK	446
14	Muhamet Spahiu	AAK	373
15	Xhelal Celaj	AAK	313
16	Sali Butyqi	AAK	311
17	Ilirian Bytyqi	AAK	265
18	Nadira Hoxha	AAK	231
19	Refki Bytyqi	AAK	229
20	Albane Asselina	AAK	201
21	Vjollca Rraqi	AAK	193
22	Safet Hoxha	PDK	7348
23	Jemin Zeqiraj	PDK	571
24	Shaban Gollopi	PDK	531
25	Zymer Llugaxhiu	PDK	403
26	Murtez Zekolli	PDK	400
27	Flurim Kryeziu	PDK	362
28	Zoje Zenelaj	PDK	323
29	Luan Sahitaj	PDK	297
30	Hanife Rrakaqi	PDK	209
31	Florie Bytyqi	PDK	137
32	Muhamet Bajraktari	LDD	1439
33	Leonora Reshitaj	LDD	53
34	Halit Berisha	AKR	503
35	Adem Kadolli	PSK	479

Anëtarët e rinj të Kuvendit të Komunës së Rahovecit

Nr	Anëtarët	Subjekti politik	Numri i votave të marra në zgjedhjet e fundit
1	Dervish Cadraku	PDK	5989
2	Salih Sallteku	PDK	433
3	Xhelal Canziba	PDK	365
4	Rasim Fazliu	PDK	351
5	Lirih Berisha	PDK	324
6	Xhevdet Duraku	PDK	315
7	Fatmir Kadiri	PDK	300
8	Lumturie Hoti	PDK	161
9	Fane Thaci	PDK	157
10	Beatrisa Demiri	PDK	131
11	Nahit Elshani	LDK	4344
12	Kujtim Popaj	LDK	326
13	Avdullah Kryeziu	LDK	305
14	Burim Krasniqi	LDK	225
15	Rrustem Thaqi	LDK	217
16	Marigona Berisha	LDK	143
17	Mirjeta Morina	LDK	134
18	Kosovare Kelmendi	LDK	102
19	Feim Fetoshi	AAK	3105
20	Labinot Berisha	AAK	280
21	Elhami Zhuniqi	AAK	212
22	Iliriana Gashi	AAK	131
23	Rukija Krasniqi	AAK	102
24	Rexhep Oruqi	AKR	2321
25	Sinan Ejupi	AKR	150
26	Blerina Krasniqi	AKR	91
27	Fahrije Hoti	AKR	66
28	Sali Hoti	LIB	1408
29	Florije Boshnjaku	LIB	120
30	Xhihad Vuqitërna	PD	686
31	Esad Haxhijaha	LDD	641

Përfaqësimi i qytetarëve në kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit

Anëtarët e rinj të Kuvendit të Komunës së Malishevës			
Nr	Anëtarët	Subjekti politik	Numri i votave të marra në zgjedhjet e fundit
1	Ragip Begaj	PDK	10078
2	Adem berisha	PDK	556
3	Naim Morina	PDK	487
4	Enver Hoti	PDK	450
5	Feim Hoxha	PDK	425
6	Luan Morina	PDK	408
7	Asllan Kastrati	PDK	396
8	Hysni Gashi	PDK	391
9	Blerim Thaci	PDK	360
10	Raimonda Krasniqi	PDK	352
11	Fadil Shala	PDK	344
12	Hasime Krasniqi	PDK	328
13	Ramë Bibaj	PDK	327
14	Sevdija Kryeziu	PDK	234
15	Florie Zogu	PDK	232
16	Merita Krasniqi	PDK	215
17	Januz Kastrati	LDK	6687
18	Rrahim Morina	LDK	335
19	Milazim Kryeziu	LDK	312
20	Zahide Kastrati	LDK	279
21	Bekim Samadraxha	LDK	276
22	Feta Rudaj	LDK	271
23	Sami Kafexholli	LDK	246
24	Besnik Hoti	LDK	243
25	Firasete Morina	LDK	171
26	Jetmire Hoxha	LDK	160
27	Filloreta Bytyqi	LDK	151
28	Avni Robaj	AAK	1046
29	Dituri Morina	AAK	64
30	Milazim rudi	LDD	326
31	Hafir Rexha	AKR	811

Anëtarët e rinj të Kuvendit të Komunës së Dragashit

Nr	Anëtarët	Subjekti politik	Numri i votave të marra në zgjedhjet e fundit
1	Mitat Fejza	PDK	3901
2	Lulzim Rifaj	PDK	372
3	Habib Osmani	PDK	344
4	Shaban Shabani	PDK	279
5	Ymridin Fetahu	PDK	264
6	Hamzi Hule	PDK	244
7	Arbënora Kryeziu	PDK	100
8	Nazmije Velija	PDK	84
9	Lulbardha Berisha	PDK	77
10	Ymer Ademi	LDK	3727
11	Samedin Xheladini	LDK	683
12	Kapllan Fetahu	LDK	265
13	Zahadin Destani	LDK	232
14	Naim Baxhaku	LDK	210
15	Naim Ramadani	LDK	207
16	Shqipe Halili	LDK	123
17	Gajbije Qengaj	LDK	123
18	Arjeta Skeraj	LDK	155
19	Blerim Piraj	AAK	846
20	Luljete Berisha	AAK	50
21	Qamil Kolloni	LDD	499
22	Muhidin Jusufi	AKR	466
23	Serif Aga	VAKAT	1529
24	Veljid Hadzisini	VAKAT	347
25	Zinaida Elmazi	VAKAT	40
26	Deir Jelmazi	GIG	454
27	Nihat Osmani	SDA	517

STAFF

Ismet KRYEZIU - Executive Director
email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - Admin & Finance Manager
email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ - Admin & Finance Assistant
email: lcikaj@kdi-kosova.org

Emine BEHLULI - Admin & Finance Assistant
email: ebehluli@kdi-kosova.org

PROGRAM - CENTRAL GOVERNANCE

Valmir ISMAILI - Program Manager
email: vismaili@kdi-kosova.org

Driton SELMANAJ - Program Assistant
email: dselmanaj@kdi-kosova.org

Fitore ZENELI - Program Assistant
email: fzeneli@kdi-kosova.org

Isuf ZEJNA - Monitor
email: izejna@kdi-kosova.org

Ramadan KLISURICA - Monitor
email: rklisurica@kdi-kosova.org

Rrezarta AHMETI - Monitor
email: rrahmeti@kdi-kosova.org

PROGRAM - LOCAL GOVERNANCE

Naim CAHANAJ - Program Manager
